

VENDIM
Nr. 748, datë 5.9.2013

**PËR LEJIMIN E KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK DHE
ZHBLLOKIMIN E FONDEVE PËR INVESTIME TË VITIT 2013, PËR PROKURORINË E
PËRGJITHSHME, PROKURORINË E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR DHE
PROKURORINË E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEÇ, SI AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e zhbllokimit të fondeve për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, të cilat i përkasin fondit të investimeve të parashikuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 2013, e të përfshirë në aneksin nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Prokuroria e Përgjithshme dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha